



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-
Komisioni i Konkurrencës**

V E N D I M

nr. 434, datë 21.09.2016

**“Për
përrjashtimin e marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike
ndërmjet KESH dhe OSHEE, për tepricat e energjisë elektrike në kushtet
e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e
shpërndarjes për periudhën 1 Korrik 2016 deri Dhjetor 2016”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
Servete	GRUDA	Zv/Kryetar
Koço	BROKA	Anëtar
Iva	ZAJMI	Anëtar
Eduard	YPI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.09.2016 shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Përrjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH SHA dhe OSHEE SHA, për tepricat e energjisë elektrike, përrfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, për periudhën 1 Korrik 2016 deri në 31 Dhjetor 2016”

Baza ligjore: Ligji nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 5, pika 2, neni 24, shkronja d, neni 49 dhe neni 50 pika 1.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përrgjithshëm “Mbi përrjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH SH.A. dhe OSHEE SH.A, me qëllim plotësimin e humbjeve ne rrjetin e shpërndarjes për periudhën 1 Korrik 2016 deri në 31 Dhjetor 2016“, përrfshirë tepricat në kushtet e prurjeve te mëdha” të amenduar.

VËREN SE :

I. Procedura e ndjekur

ERE me anë të shkresës nr. 643 prot, datë 30.08.2016 (protokolluar pranë AK me nr. 296 prot, dt. 31.08.2016) drejtuar Autoritetit të Konkurrencës, na njofton për fillimin e procedurave për miratimin e kontratës së shitblerjes se

energjisë elektrike ndërmjet shoqërive KESH SH.A. dhe OSHEE SH.A. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.07.2016 – 31.12.2016. Amendimi konsiston në shtyrjen e afatit kohor të marrëveshjes deri në datën 31 Dhjetor 2016.

Gjatë vlerësimit të “Marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërive KESH SH.A. dhe OSHEE SH.A. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha me qëllim plotësimin e humbjeve të sistemit të shpërndarjes për periudhën kohore 01.07.2016 – 31.12.2016”, sekretariati administroi informacion nga OSHEE SHA, KESH SHA dhe ERE në lidhje me procedurat e blerjes së energjisë elektrike për periudhën Janar-Qershor 2016.

Në informacionin e OSHEE SHA vihet re se çmimi mesatar i blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve, nga tregtuesit e energjise për periudhën Janar - Qershor 2016, është 45.37 Euro/MW çmimi, ndërsa çmimi i blerë nga KESH SH.A, nëpërmjet marrëveshjes 27.77 euro/MW.

Për sa më sipër, meqenëse amendimi prek vetëm shtyrjen e afatit kohor të marrëveshjes për periudhën 1 korrik 2016 – 1 Dhjetor 2016, ndërsa kushtet dhe detyrimet ndërmjet palëve mbeten të njejta, mbetemi ne konstatimin se kemi të bëjmë me një marrëveshje vertikale të lidhur ndërmjet dy kompanive publike KESH dhe OSHEE, e cila është përjashtuar nga rregulli për shkak të kushteve specifike në të cilat ajo zbatohet, pasojave sociale dhe sigurisë kombëtare. Pra, nuk bie në kundërshtim me Ligjin nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar) dhe duhet të përjashtohet nga ndalimi sipas nenit 5 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar).

Arsyet e pranimit të amendimit:

- 1) Marrëveshja kontribuon në shfrytëzimin maksimal dhe optimizimin e prodhimit dhe të shitjes së energjisë elektrike nga KESH SHA/KESH Gen, si shoqëria përgjegjëse dhe administruuese e Kaskadës së Lumit Drin dhe HEC- eve prodhuese të saj, në kushtet e të plotave apo prurjeve të mëdha. Pra marrëveshja do të kryhet për shkak të efikasitetit të tregut të energjisë dhe efikasitetit të aktorëve kryesorë të tregut KESH SHA dhe OSHEE SHA. Nga të dhënat e gjashtemujorit të parë të vitit 2016 rezulton se çmimi i shitjes së energjisë nga KESH SHA është shumë i ulët (deri në 10.47 EUR/MWh) ndërsa çmimi i blerjes së energjisë nga OSHEE nga tregtaret është 45.37 EUR/MWh.
- 2) Efienca e marrëveshjes duhet të sjellë përfitime esenciale për konsumatorët tariforë, duke patur parasysh që kostot e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të marrëveshjes kanë rënë ndjeshëm, kjo duhet të reflektohet në ulje të tarifave të furnizimit me pakicë për konsumatorët tariforë, pra duhet të reflektohen në tarifatat e konsumatorëve fundorë.

- 3) Marrëveshja do të aplikohet për periudhën kohore 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016, kohë në të cilën duhet të përfundojë miratimi i akteve nënligjore të tregut të energjisë elektrike.

PËR KËTO ARSYE :

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 5, nenit 50 të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” , i ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Të përjashtojë nga ndalimi marrëveshjen e shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH dhe OSHEE, për tepricat e energjisë elektrike në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016.
2. Për procedurat e blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, të cilat janë të ndryshme nga ato të pikës 1, duhet të zbatohen rregullat e garës së hapur.
3. ERE duhet të reflektojë në tarifat e energjisë elektrike për klientët fundorë kostot reale të blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, duke reflektuar përfitimet që sjell marrëveshja ndërmjet OSHEE SHA dhe KESH SHA.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)
Zv. Kryetare

Koço Broka

(_____)
Anëtar

Iva Zajmi

(_____)
Anëtare

Eduard YPI

(_____)
Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R E